

Ndryshimet klimatike që ndjehen këto ditë janë me shpejtësi dhe kohëzgjatje që nuk është ndier në 120 mijë vitet e fundit. Ato ndryshime mund të vërehen edhe në Maqedoni.

Sipas ekspertëve të ambientit jetësor, ky proces është bërë më së shumti për shkak të gazrave të oëmshme që i prodhon njeriu në fillimin e revolucionit industrial. Këto gazra i mbajnë rrezet e diellit në atmosferë, ndërsa me këtë arrihet një proces i cili është i ngjashëm me kopshin qelqor i cili kryhet në atmosferë. Për shkak të kësaj, këto gazra quhen gazra qelqore. Ato gazra janë: karboni dyoksid (CO₂), i cili lëshohet gjatë djegies së materialeve që përbëjnë karbon, metani (CH₄), oksidet azotike (N₂O), karbohidratet halogjenë dhe sulfuri heksafluorid (SF₆), këto janë gazra të panatyrshme në atmosferë.

Pa efektin natyror të kopshit qelqor, temperatura mesatare në planetin Tokë do të ishte 30°C më e ulët se ajo momentale. Nga revolucioni industrial, niveli i gazrave qelqore është shumë i zmadhuar në atmosferë, e për shkak të kësaj kemi arritur një balancë e cila shkatërrohet lehtë. Si rezultat i kësaj, atmosfera është e shkatërruar dhe vështirë se do të mund të riparohet në njëqind, bile njëmijë vitet e ardhshme.

Në qoftë se nuk doni ta jetoni jetën tuaj në një planet të papastër për shkak të kushteve kohore të padurueshme, atëherë është më mirë që momentalisht të bëni diçka.

I. Ndryshimi i kushteve kohore

Ju personalisht mund t'ju ndieni gjendjet kohore. Temperaturat e reja regjistrohen gjithnjë e më shpesh dhe në disa vende ka shira që zgjasin shumë gjatë, kurse në disa vende të tjera ato janë shumë më të rralla. Stuhi brutale me bubullime dhe vetëtime ka gjithnjë e më shumë.

Njëri i fenomenëve më destruktive të atmosferës janë ciklonet tropikë të cilat formohen nga uraganet në Oqeanin Atlantik. Ato e marrin energjinë e ujit detar, i cili rrxehet nga rrezet e diellit. Ciklonet tropikë formohen kah fundi i verës. Ato vijnë me erëra të fuqishme dhe shira të fuqishme, kurse pas vetes mbeten vendbanime të shkatërruara.

Në Evropë, gjithnjë e më shumë ndodh një stuhi i cili mban me vete uragane dhe bubullime. Dukuritë e këllilla dalin si pasojë e koncentracionit të rritur të gazrave qelqore në atmosferë, e me vetë kjo vjen deri te ndryshimi i kushteve kohore. Për shkak të ndryshimeve klimatike, duhet të përgatitemi për bubullime ende më të fuqishme që do të mbajnë me vete erëra, shira dhe breshër.

Në qoftë se ndryshimet klimatike vazhdojnë të zhvillohen si deri më tani, do të duhet të presim që këto fenomene të paraqiten gjithnjë e më shpesh dhe me forma më të keqja nga ato të mëparshmet.

II. Ndryshimet e ambientit jetësor

Pasojat më spektakulare nga ndryshimet klimatike janë ngrirja e pjesëve të Arktikut dhe të Antarktikut, si dhe majat e ngrira të maleve të larta të cilat kanë qenë të paprekshme me mijëra vite. Sipas parashikimeve, mburoja e ngrirë në Rethin e Arktikut do të zhdoket tërësisht kah fundi i shekullit tonë. Nga njëra anë kjo do të rezultojë me një oem të pakthyeshmë për popullatën që jeton në atë krahinë, kurse nga ana tjetër do të rritet niveli i ujit në oqeanet.

Ndryshimet klimatike nuk do të thotë vetëm ndryshime të temperaturës. Shpërndarja e shirave do të jetë edhe më e pabarabartë. Sasia e tyre do të zvogëlohet në krahinat më të mëdha, kurse në krahinat e tjera do të rritet në mënyrë të konsiderueshme. Mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm mund të ndikojë mbi më shumë se gjysma e njerëzve. Për shkak të shirave të shumta ose të pakta, sipërfaqeve bujqësore do të japin kontribute më të vogla, kurse kjo do të shkaktojë një mungesë të ushqimit.

Për shkak të Ndryshimeve klimatike do të zhvendoset brezi klimatik, kurse kjo do të shkaktojë efekte brutale mbi botën shtazarake. Kjo zhvendosje është më e shpejtë se mija e drurëve e me vetë kjo pyjet nuk do të jenë të afta të adaptohen me kohë me ndryshimet klimatike. Drurët marrin një sasi të madhe të karbonit dyoksid nga atmosfera dhe njëkohësisht ata prodhojnë oksigjen dhe në atë mënyrë ata kontribuojnë për ndalimin e ndryshimeve katastrofale klimatike. Këto efekte i dëmtojnë bazat e biosferës së tokës e cila po ashtu ndikon edhe mbi njerëzit.

III. Cilat janë shkaqet?

Mbeturinat – madhësia

Madhësia e mbeturinave që nuk janë të mblëdhura është një shembull i mirë i mendimit të papërgjegjshëm. Pjesa më e madhe e mbeturinave është ambalazhi. Në vend që të shfrytëzojmë materiale të ricikluara për mbështetje ose shishe të ricikluara, ne përdorim teknika për mbështetje të cilat gjithnjë e më shumë janë zgjeruar anembanë botës, kurse për to harxhohet një sasi e madhe energjie dhe materiale të tjera. Po ashtu, këto teknika prodhojnë mbeturina të cilat i shkaktojnë ndryshimet klimatike. Nga njëra anë energjia për prodhimin e tyre është një harxhim i panevojshëm, kurse nga ana tjetër materialet e prodhuara të mbeturinës ndotin ambientin tonë jetësor për qindra vite dhe lëshojnë metan në atmosferë, kurse ai gaz gjendet në grupin e gazrave qelqore.

Oxhaqet

Neve na duhet energji për: llambat në shtëpitë tona, për të shikuar televizionin, për të punuar me aparatet e amvisënsë. Atë energji elektrike e marrim në shtëpitë tona në zëvendësim për diçka. Pjesa më e madhe e energjisë elektrike prodhohet në termocentralët të cilat lëshojnë miliona tonelata karbon dyoksid në atmosferë.

Transporti

Automobilat ndoshta na lehtësojnë jetën, por nuk duhet të harrojmë se ato prodhojnë një sasi të madhe karboni dyoksid në atmosferë sepse djegin karburante fosile (naftë, benzinë). Duke u vozitur me automobil për kënaqësi personale, ne konsiderueshëm rritim shpejtësinë e ndryshimeve klimatike. Transporti ajror është mënyra më e shpejtë transporti në këtë kohë bashkëkohore, por në këtë grup gjendet edhe metoda më e ndotur e transportit.

IV. Çfare mund të bëjmë?

Shfrytëzoje energjinë në mënyrë efikase!

Pjesa më e madhe e energjisë formohet duke e ndotur ambientin jetësor, e me kursimin e saj do ta kursejmë edhe ambientin jetësor. Për informata më të hollësishme shikoni posterin tonë "Energjia në shtëpitë".

Në qoftë se doni ta mbronni tokën nga ndryshimet klimatike shfrytëzoni transportin publik (autobus, tramvaj, tren, metro, anije), por nëse udhëtoni në një relacion të shkurtër, atëherë mos u nguroni dhe shfrytëzoni biçikletë, për shkak se nuk ka makinë ekologjiksht më të pranueshme nga trupi juaj.

Përdor burimet e ripërsëritura të energjisë!

Në qoftë se shfrytëzoni energjinë e prodhuar nga burimet e ripërsëritura siç janë (dielli, ari, gjlma, biomasa) atëherë jeni të sigurt se nuk jeni një ngarkesë e madhe për atmosferën, meqë në atë rast nuk prodhohen gazra qelqore. Për detaje më të hollësishme shikoni posterin tonë "Dunmë mirëmbajtëse të energjisë".

Mbjellja e drurëve!

Drurët marrin një sasi të madhe të karbonit dyoksid nga atmosfera dhe njëkohësisht prodhojnë oksigjen dhe në atë mënyrë ata kontribuojnë për ndalimin e ndryshimeve katastrofale klimatike. Çdo dru i mbjellë është një hap i vogël përpara drejt mbrojtjes së planetit tonë.

Bli prodhime që janë bërë në mënyrë lokale dhe janë bërë nga materiale të ricikluara!

Në qoftë se blini prodhime nga materiale të ricikluara ose nga materiale natyrore, atëherë kontribuoni për mbrojtjen e klimës sonë, sepse nuk bëhen mbeturina. Për prodhimet e bëra nga materiale të ricikluara harxhohet më pak energji, e me kjo lëshohen më pak gazra qelqore në atmosferë. Në qoftë se zgjidhni të blini prodhime vendore, atëherë do ta zvogëloni ndotjen e atmosferës që arrihet gjatë transportit të tyre. Me atë do ta zvogëloni ngarkesën mbi atmosferën.

Zgjeroni porosinë tonë!

Gjatë shetitjeve tuaja nëpër botën me sy të hapur do të kuptoni natyra funksionon dhe se njerëzimi është edhe një element i barabartë i cili ndikon mbi atë cikël. Me një përkushtim të vogël të vëmendjes mbi mbrojtjen e balancës natyrore do të kontribuoni për ndalimin e ndryshimeve klimatike dhe mbrojtjen e planetit tonë. Transmetoni informatat për ndryshimet klimatike deri te miqtë tuaj – sa më shumë dinë ata, aq më efikase do të punojmë kundër tyre.